

PKR.nr.637/15

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Suzana Çerkini, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit T. M. nga fshati R., Komuna M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr. 690/2015, të dt. 30.10.2015, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 13.12.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të pandehurit T. M., po të njëjtën datë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri T.M.**, i biri i Sh. dhe nënës R., e vajzërisë H., i lindur me *data e lindjes...* në M., tani me vendbanim në fshatin R. Komuna M., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me nr. personal *numër personal...*

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse, me datë 08.08.2015, rreth orës 21:10h, patrulla policore gjate një kontrolli rutinore në vendin e quajtur “Te rrethi i Flamurit”, në Prishtinë, ka ndaluar veturën e markës “BMW”, në ngjyrë e bardhë, me targa *numër i targave...*, që e ka drejtuar i pandehuri T., ku gjatë kontrollimit të veturës, në sirtarin e përparëm, i kanë gjet dhe sekuestruar një revole të të markës “Zastava”, ngjyrë e zezë, me numër serik 114137, se bashku me një karikator dhe tetë (8) copë fishek, kalibër 7.65 mm, te cilën i pandehuri e mbante në posedim pa autorizim, përkatësisht pa leje valide të lëshuar nga organet kompetent,-

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 49, 50, 51, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe nenit 248, 365, 366 të KPP, i shqiptoi:

## DËNIM ME KUSHT

Në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muajsh**, i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **1 (një) viti** nuk do të kryejë vepër të re penale, si dhe

## DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohen: një revole e markës “Crvena Zastava”-Cal.7.65 mm Mod 70, me numër serik 114137, se bashku me një karikator i pistoletës dhe tetë (8) copë fishek, kalibër 7.65 mm, të precizuara si në vërtetimin mbi marrjen e përkohshme të sendeve 2015-AD-2507, të datës 18.08.2015, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i pandehuri t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, obligohet të paguajë shumën prej nga **50 (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.nr. 690/2015, të dt. 30.10.2015, ka akuzuar të pandehurin T. M., për vepër penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që, pas administrimit të provave të propozuara në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar, në të cilin i pandehuri T. M. duke u vënë në dijeni të plotë për pasojat dhe përparsit e pranimin të fajësisë, me vullnet dhe vetëdije të plotë, e pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për çka theksoi se ndihet i penduar, kjo ka qenë hera e parë të ketë rënë ndesh me ligjin dhe premtoi se edhe në të ardhmen nuk do të përsëris vepër të tillë apo të ngjashme, andaj e lut gjykatën që ti shqiptojë dënim sa më të butë.

Pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri, prokurori i shtetit theksoi se pajtohet me pranimin e fajësisë, konsideroi se i pandehuri ka kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe se ky pranim është në përputhje me provat nga shkresat e lëndës, andaj i propozoi gjykatës që gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe vullnetarisht ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimin të fajësisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, e aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri T. M., për veprën penale e cila u vihet në barrë.

Andaj, meqë në veprimin e të pandehurit formësohen të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë matjes dhe përcaktimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, si rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, moshën e tij të re, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur, premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i përcaktoi dënim me burgim të cilin ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, të precizuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe se të njëjti, në të ardhmen nuk do të përsëris vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimi për konfiskimin e armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.637/15, me datë 13.12.2016**

**Sekretarja juridike  
Ardita Azemi**

---

**Kryetarja e trupit gjykues-Gjyqtarja  
Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.